


Drejtoria e Shëndetësisë heton mjekët e lidhur me kompanitë farmaceutike

Arian Duriqi

LIPJAN, 16 MAJ – Drejtoria e Shëndetësisë e Lipjanit ka ftuar udhëheqësin e institucionit primar shëndetësor në këtë komunë, përkatësisht drejtorin, dhe e ka urdhëruar të bëhet një takim urgjent me të gjithë mjekët që funksionojnë në kujdesin primar shëndetësor. Kjo, lidhur me një shqetësim që është ngritur rreth bashkëpunimit të disa profesionistëve shëndetësorë të caktuar dhe kompanive farmaceutike për të reklamuar produktet e tyre. Takimin urgjent e ka konfirmuar të enjten për gazetën Fitim Mziu, drejtor i Shëndetësisë në Lipjan. “Kam urdhëruar të bëhet një takim urgjent me të gjithë mjekët që funksionojnë në kujdesin primar shëndetësor, lidhur me një shqetësim që është ngritur rreth bashkëpunimit të individëve të caktuar dhe kompanive farmaceutike. Sepse mjekët s’kanë të drejtë të bashkëpunojnë me asnjë kompani farmaceutike për të detyruar qytetarët ta blejnë atë apo këtë medikament, pasi që në këtë aspekt janë në konflikt me ligjin dhe jashtë etikës profesionale”, ka thënë Mziu. Në të vërtetë, meqë në Lipjan është vënë re se në institucione shëndeti po

reklamohen produkte kompanish farmaceutike, shoqëria civile në këtë mjedis, përkatësisht OJQ “YAHR” ka reaguuar publikisht dhe shprehur shqetësimin për këtë punë.

“YAHR” shpreh shqetësimin, lidhur me një dukuri shumë shqetësuese që po ndodh në sektorin shëndetësisë në Lipjan. Ka individë të caktuar që punojnë në sektorin privat dhe atë publik të shëndetësisë që në mënyrë direkte janë lidhur me kompanitë të caktuara farmaceutike me qëllim të promovimit dhe të shitjes të produkteve të tyre në dëm të qytetareve”, ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në “YAHR”. Ai ndërkaq ka shprehur dyshimet se kjo është një marrëveshje e fshehtë që kanë lidhur punëtorët shëndetësorë me kompanitë në fjalë. “Këto kompani farmaceutike kanë lidhur marrëveshje të fshehtë me individë të caktuar të sektorit shëndetësisë, të cilët po i detyrojnë pacientet që të blejnë barna nga këto kompani me çmime më të larta krahasuar me të njëjtin bar nga kompania tjetër. Dhe, si rezultat i kësaj këta individë po marrin shpërblim nga këto kompani. Kjo dëshmohet me prezencën e fletushkave dhe posterëve të ndryshëm nga këto kompani nëpër



Fitim Mziu, drejtor i Shëndetësisë në Lipjan. “Kam urdhëruar të bëhet një takim urgjent me të gjithë mjekët që funksionojnë në kujdesin primar shëndetësor, lidhur me një shqetësim që është ngritur rreth bashkëpunimit të individëve të caktuar dhe kompanive farmaceutike

këto institucione shëndetësore”, ka shtuar Krasniqi. Mirëpo, nga ana tjetër, edhe drejtori i Shëndetësisë, Mziu, këmbëngul se do të luftohet ashpër kjo dukuri, pasi që sipas tij, tashmë edhe Ligji i ri e ndalon rreptësisht këtë reklamim. “Ky veprim tashmë me ligjin e ri është edhe konflikt interesi dhe e ndaluar rreptësisht dhe në tashmë do t’i sqarojmë profesionistët shëndetësorë sërish për përgjegjësitë individuale që kanë, sepse secili prej tyre ka kontratë individuale që qartë përkrahuan detyrat e punës, kodin etik

e profesional”, ka thënë ai. Ndërkohë vetë Mziu e ka pranuar se në disa vizita që ka pasur në QKMF-në e Lipjanit kishte dyshuar se individë nga kompanitë farmaceutike po silleshin aty dhe kishte njoftuar Inspektorinë për masa të shpejta. “Në disa vizita që kam bërë unë në kujdesin primar shëndetësor kam parë individë dhe kam dyshuar që mund të jenë të kompanive farmaceutike dhe me këtë rast kam informuar menjëherë Inspektorinë për të hetuar a kanë leje të hyjnë të bëjnë reklamim e produkteve të tyre dhe

me këtë rast kam dyshuar se kjo mund të jetë një metodë e keqpërdorimit të profesionistëve shëndetësorë”, është shprehur ai. Në fund, Mziu ka thënë se mjekët e kanë për detyrë shumicën e rasteve të përkrahur terapi me emra gjenerikë, pos rasteve kur ka vetëm emra të mbrojtur për shkak se në një tabletë bëjnë pjesë dy e më tepër lloje barnash. Ai ka thënë po ashtu se farmacisti është ai që e ofron produktin dhe jo mjeku, sepse kjo është shkelje ligji dhe konflikt interesi.

© KOHA Ditore